



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 30 gusht 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: korrik, 2024

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive, në korrik 2024 arrin 5,46% dhe shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,01 p.p. dhe 0,03 p.p., respektivisht. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 0,05 p.p. dhe 0,43 p.p., respektivisht dhe arrin 1,93%.
- Në korrik, norma mesatare e interesit të kredive të reja² arriti 5,12% dhe në bazë mujore është rritur për 0,04 p.p., me ulje vjetore prej 0,45 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja arriti 2,76% dhe është rritur për 0,24 p.p. në nivel mujor, me rritje vjetore prej 0,55 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	7.2023	8.2023	9.2023	10.2023	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.49	5.49	5.49	5.49	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46
Korporatat	5.36	5.36	5.37	5.37	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23
Amviseritë	5.61	5.61	5.61	5.60	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67
Kreditë e reja	5.57	5.53	5.49	5.55	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12
Korporatat	5.75	5.73	5.50	5.71	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96
Amviseritë	5.32	5.24	5.47	5.28	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34
Depozitat	1.50	1.55	1.59	1.67	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93
Korporatat	2.02	2.08	1.94	1.96	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28
Amviseritë	1.44	1.50	1.55	1.64	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89
Depozitat e reja	2.21	2.17	2.15	2.32	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76
Korporatat	1.57	1.81	1.65	1.51	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03
Amviseritë	2.40	2.32	2.40	2.57	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68

Burimi: BPRMV-ja.

¹Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf


²Lidhur me normata e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike zhvillime të ndryshueshme. Lëvizjet e tilla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

1. Norma të interesit në sektorin korporativ³


- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive të sektorit korporativ, këtë muaj, shënoi rënie mujore prej 0,03 p.p. dhe shënon 5,23%. Analizuar sipas valutës, ndryshimi rezulton nga normat më të ulëta të interesit për kreditë valutore dhe kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,13 p.p., përkatësisht 0,12 p.p.), me rritje të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,02 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, kjo normë interesi është ulur për 0,13 p.p.




Burimi: BPRMV-ja.



- Në korrik, norma e interesit e kredive të reja të sektorit korporativ është 4,96% dhe shënoi rritje mujore prej 0,01 p.p. Ndryshimi është rezultat i rritjes së normave të interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,82 p.p., respektivisht 0,10 p.p.) në kushte kur normat e interesit të kredive në valutë të huaj janë ulur (për 1,35 p.p.). Krahësuar me korrikun e vitit të kaluar, norma e interesit për kreditë e reja për sektorin korporativ është ulur për 0,79 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.





³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ, në korrik, është më e lartë për 0,03 p.p. dhe shënon 2,28%. Ndryshimi në rritje është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,05 p.p.), në kushte të normave të pandryshuara të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore dhe rënies së depozitave në valutë të huaj (për 0,01 p.p.). Rritja vjetore e normës së interesit arrin 0,26 p.p.
- Këtë muaj, norma e interesit të depozitave të reja⁴ të sektorit korporativ është rritur për 0,64 p.p. dhe është 3,03%. Njëkohësisht, rritja është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe normave të interesit për depozitat valutore (për 0,68 p.p., përkatësisht 0,13 p.p.). Në korrik, te bankat dhe kursimoret nuk janë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Në nivel vjetor, norma e interesit të depozitave të reja të sektorit korporativ shënoi një rritje prej 1,46 p.p.

2. Norma të interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV-ja.

- Norma e interesit e totalit të kredive të amvisërive, në korrik, arrin 5,67%, që paraqet rritje mujore prej 0,01 p.p. Ndryshimi mujor është në tërësi për shkak të rritjes së normave të interesit për kreditë në denarë pa klauzolë valutore (për 0,04 p.p.), në kushte të rënies së normave të interesit për kreditë valutore dhe kreditë në denarë me klauzolë valutore (për 0,04 p.p, përkatësisht 0,03 p.p.). Krahasuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit është rritur për 0,06 p.p.


⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normave të interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në korrik, norma mesatare e interesit të kredive të reja të amvisërive është 5,34% dhe shënoi rritje mujore prej 0,05 p.p. Rritja është rezultat i rritjes së normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore dhe të kredive valutore (për 0,13 p.p., respektivisht 0,03 p.p.), me rënie të normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,11 p.p.). Kjo normë e interesit është rritur për 0,02 p.p., në bazë vjetore.



Burimi: BPRMV-ja.



- Norma e interesit të totalit të depozitave të amvisërive këtë muaj arrin në 1,89% duke shënuar një rritje mujore prej 0,05 p.p. Rritja vjen si rezultat i normave më të larta të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të depozitave valutore (për 0,06 p.p. dhe 0,04 p.p., respektivisht), ndërsa normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore janë reduktuar (për 0,02 p.p.). Në krahasim me muajin korrik të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është rritur për 0,45 p.p.
- Në korrik, norma e interesit të depozitave të reja të amvisërive⁶ shënon rritje prej 0,13 p.p. dhe arrin në 2,68%. Njëkohësisht, ndryshimi në rritje është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe normave të interesit të depozitave valutore (për 0,17 p.p., përkatësisht 0,06 p.p.). Te bankat dhe kursimoret këtë muaj nuk janë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Në bazë vjetore, norma e interesit të depozitave të reja të amvisërive shënoi një rritje prej 0,28 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 shtator 2024 (mesatarja referuese, përfshirë gusht e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235, lok. 108/110.